



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

U R D H Ë R

Nr. 102 Datë 23. 03. 2004

**PËR
DELEGIMIN E KOMPETENCAVE DHE CAKTIMIN E DISA RREGULLAVE
ADMINISTRATIVE NË ZYRËN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

Me synim,

- delegimin e disa kompetencave e përgjegjësive drejtuesve të strukturës të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe;
- caktimin e disa rregullave administrative të brendëshme për lëvizjen e akteve dhe shkresave në strukturat e kësaj Zyre;

Në mbështetje, të nenit 8 pika 2 e vijues të ligjit Nr. 8737 datë 12.

02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin Nr. 9102 datë 10. 07. 2003,

U R D H Ë R O J :

**I. DELEGIMI I DISA KOMPETENCAVE NË ZYRËN E
PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM.**

1. Drejtorëve të drejtorive të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm që ushtrojnë funksione procedurale penale, të ndihmuar nga shefat e sektorëve dhe prokurorët pranë tyre, sipas grup veprave dhe drejtimeve që mbulojnë, u delegoj kompetencat e prokurorit më të lartë¹:
 - 1.1. për të analizuar dhe vierësuar ecurinë dhe ligjshmërinë e ndjekjes penale në hetimet paraprake dhe në shqyrtimin gjyqësor të çështjeve në të gjitha nivelet e prokurorive, si dhe në ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit;
 - 1.2. për të urdhëruar ose udhëzuar² me shkrim kryerjen e veprimeve hetimore të

¹ Shih, - nenin 4 pika 3 paragrafi dylë i ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin Nr. 9102 datë 10. 07. 2003, si dhe;

- vendimin unifikues Nr. 4 datë 14.10. 2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Larli, 1 Shih, neni 24/4 i K. Pr. Penale.

² Shih nenin 24/4 i K.Pr. Penale.

domosdoshme për plotësimin e hetimeve paraprake ose për ndryshimin apo plotësimin e kualifikimit ligjor të veprës penale;

- 1.3. për të vendosur ndryshimin ose shfuqizimin e akteve të prokurorit më të ulët³ në hetimet paraprake, si vendime; pushimi çështje ose akuze, pezullimi të hetimeve ose mosfillimi të procedimit, kur ato konstatohen të pabazuar në ligj ose në prova, ashtu dhe të akteve të tjera në rastet kur çmohet se janë të pavlefshëm⁴;
- 1.4. për te bërë ankim, brenda afatit ligjor, në rastet kur vlerësohet që çështja duhet ankimuar dhe kjo e drejtë' nuk ushtrohet nga prokurori i çështjes ose drejtuesi i prokurorisë përkatëse.

2. Drejtorët për ushtrimin e kompetencave të deleguara me këtë urdhër duhet të vënë në dijeni herë pas here Prokurorin e Përgjithshëm.

3. Në rastet kur nga ushtrimi i delegimeve të përmendura në pikën I, 1.1 deri 1.4 të këtij urdhëri, del se duhet lehtësuar pozita e të pandehurve ose personave nën hetim, drejtorët para dhënies së mendimit dhe formulimit të aktit përkatës duhet të vënë në dijeni Prokurorin e Përgjithshëm.

4. Në formulimin e akteve procedurale penale të përcaktuara në pikën 1-1.1 deri 1.4 të këtij urdhëri, të bëhet kujdes në arsyetimin e bazës ligjore, ku krahas mbështetjes në dispozitat përkatëse të K. Pr. Penale, etj. duhet të shenohet edhe numri dhe data e këtij urdhëri.

II. DISA RREGULLA ADMINISTRATIVE TË BRENDËSHME PËR LËVIZJEN E AKTEVE DHE SHKRESAVE NË ZYRËN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM.

1. Shkresat për kërkimin dhe kthimin e fashikujve të hetimeve paraprake ose të dosjeve gjyqësore të bëhen në emër të Sekretarit të Përgjithshëm, pasi të jenë cikluar nga drejtoret përkatës.

- 1.1. Kur vjen fashikulli apo dosja e kërkuar, sekretaria ia kalon atë drejtpërdrejtë drejtorit të drejtorisë që e ka kërkuar.

2. Drejtorët që u delegohen kompetenca sipas këtij urdhëri, kanë të drejtë të firmosin aktet përkatëse procedurale dhe shkresën përcjese të tyre, si dhe të përdorin në to vulën e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

³ Po aty neni 24/5.

⁴ Po aty nenin 130/4.

3. Përgjigjet zyrtare për letrat, ankesat dhe kërkesat e zgjidhura të popullit ose për ato që nuk janë në kompetencë të kësaj Zyre, të bëhen në emër të Sekretarit të Përgjithshëm, pasi të jenë cikluar nga drejtori i Drejtorisë përkatëse apo shefi i Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun.

4. Kërkesat për punësim në vendet e shpallura vakant, sekretaria ia kalon drejtpërdrejtë drejtorit të Drejtorisë së Personelit dhe Inspektimit, icili here pas here bën listën e grupuar, sipas personave dhe vendeve të kërkuara prej tyre, duke venë në dijeni Prokurorin e Përgjithshëm.

5. Korespondencën e karakterit administrativ dhe financiar, sekretaria ia kalon drejtpërdrejtë Sekretarit të Përgjithshëm, i cili organizon, drejton, kontrollon, si dhe përgjigjet për trajtimin e mëtejshëm dhe zgjidhjen e tyre.

III. NJOHJA, ZBATIMI, KONTROLI DHE PËRGJEGJESIA PËR SHKELJET

1. Me këtë urdhër të njihen prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, punonjësit e administratës dhe drejtuesit e Prokurive të të gjithë niveleve.

2. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen, drejtuesit e Prokurive të të gjitha niveleve dhe prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, punonjësit e administratës dhe drejtuesit e strukturës të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

3. Mospërbushja e detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, përbën shkelje të disiplinës në punë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHEM
THEODHORI SOLLAKU